



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 511 prot.

Vlorë, më 12.01 .2018

VENDIM

Nr. 1, datë 12.01.2018

PËR

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE PËR VITIN
AKADEMIK 2018-2019**

Mbështetur në nenin 74, pika 2 të Ligjit 80/20 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 13.01.2017

V E N D O S I:

1. Miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve për vitin akademik 2018-2019 si vijon:

a) Fakulteti i Shendetit Publik:

Kriteret e pranimit për programin studimit "Bachelor në Infermieri të Përgjithshme" për vitin akademik 2018-2019 të jenë si më poshtë:


1. Kriteri përzgjedhës me 100% të pikëve do të jetë renditja zbritëse sipas mesatares së shkollës së mesme, me nivel minimal të përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
2. Nëse do të ketë studentë me të njëjtën mesatare dhe me pikë të njëjta në rankim, si kriter përzgjedhës do të merret mesatarja e lëndëve Biologji dhe Kimi.

Kriteret e pranimit për programin studimit "Bachelor në Infermieri Mami" për vitin akademik 2018-2019 të jenë si më poshtë:

1. Kriteri përzgjedhës me 100% të pikëve do të jetë renditja zbritëse sipas mesatares së shkollës së mesme, me nivel minimal të përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
SENATI AKADEMIK**

2. Nëse do të ketë studentë me të njëjtën mesatare dhe me pikë të njëjta në rankim, si kriter përzgjedhës do të merret mesatarja e lëndëve Biologji dhe Kimi.

b) Fakulteti i Shkencave Humane:

Për programin e studimit “Bachelor në Gjuhë Angleze”, kriteret të jenë si vijon:

1. Nota mesatare e tri viteve të studimit dhe e provimeve të maturës shtetërore të ketë 100% të vlerësimit në renditje.

Për programin e studimit “Bachelor në Gjuhë Italiane”, kriteret të jenë si vijon:

1. Nota mesatare e tri viteve të studimit dhe e provimeve të maturës shtetërore të ketë 100% të vlerësimit në renditje.

Për programet “Bachelor në Drejtësi”:

1. Pranimi i studentëve të rinj në vitin akademik 2018-2019, të kryhet 100% në bazë të mesatares së tre viteve të studimeve në ciklin e mesëm dhe mesatares së provimit të maturës.

Për programin e studimit “Bachelor në Gjuhë Shqipe dhe Letërsi” kriteret të jenë si vijon:

1. Nota mesatare e tri viteve të studimit dhe e provimeve të maturës shtetërore të ketë 100% të vlerësimit në renditje.

Për programin e studimit “Bachelor në Histori-Gjeografi”:

1. Nota mesatare e tri viteve të studimit dhe e provimeve të maturës shtetërore të ketë 100% të vlerësimit në renditje.

Për programin e studimit “Bachelor në Arsim Parashkollor”:

1. Nota mesatare e tri viteve të studimit dhe e provimeve të maturës shtetërore të ketë 100% të vlerësimit në renditje.

Për programin e studimit “Bachelor në Mësues për Ciklin e Ulët”:

1. Nota mesatare e tri viteve të studimit dhe e provimeve të maturës shtetërore të ketë 100% të vlerësimit në renditje.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
SENATI AKADEMIK**

Për programin e studimit “Bachelor në Pedagogji e specializuar”:

1. Nota mesatare e tri viteve të studimit dhe e provimeve të maturës shtetërore të ketë 100% të vlerësimit në renditje.

c) Fakulteti i Shkencave Teknike:

Për programet e studimit: “Bachelor në Inxhinieri Navale”, “Bachelor në Inxhinieri Mekanike”, “Bachelor në Inxhinieri Elektrike”:

1. Kriteri përzgjedhës me 100% të pikëve do të jetë renditja sipas mesatares së shkollës së mesme, me nivel mesatar të përcaktuar nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë.

2. Nëse do të ketë studentë me të njëjtën mesatare dhe me pikë të njëjta në rankim, si kriter përzgjedhës i rankimit do të merret mesatarja e Matematikës, nëse përsëri do të ketë studentë me pikë të njëjta do të merret mesatarja e Fizikës, dhe nëse edhe pas këtij rankimi do të rezultojnë studentë me mesatare të njëjta si kriter përzgjedhës do të merret mesatarja e lëndës së Kimisë.

Për programet e studimit: “Bachelor në Fizikë”, “Bachelor në Matematikë-Fizikë”:

1. Rënditja do të bëhet sipas renditjes së maturantëve kandidatë në bazë të mesatares së shkollës së mesme e përlogaritur nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë.

2. Ndër kandidatët me pikë të barabarta në “Bachelor në Fizikë”, përparësi kanë kandidatët që kanë mesatare më të lartë në lëndën Fizikë në tre vitet e studimit në shkollën e mesme.

3. Ndër kandidatët me pikë të barabarta në “Bachelor në Matematikë-Fizikë” përparësi kanë kandidatët që kanë mesatare më të lartë në lëndët Matematikë dhe Fizikë në tre vitet e studimit në shkollën e mesme.

Për programin e studimit “Bachelor në Navigacion”:


1. Kriteri përzgjedhës me 100% të pikëve do të jetë renditja sipas mesatares së shkollës së mesme, me nivel mesatar të përcaktuar nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë.

Për programin e studimit “Bachelor në Matematikë”:

1. Rënditja e maturantëve kandidatë në bazë të mesatares së Shkollës së Mesme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

2. Ndër kandidatët me pikë të barabarta përparësi kanë kandidatët që kanë mesatare më të lartë në lëndën Matematikë në tre vitet e studimit në shkollën e mesme.

Për programet e studimit: “Bachelor në Informatikë”, “Bachelor në Teknologji Informacioni”, “Bachelor në Shkenca Kompjuterike”:

1. Renditja e maturantëve kandidatë do të bëhet në bazë të mesatares së shkollës së mesme.

2. Ndër kandidatët me pikë të barabarta përparësi kanë kandidatët që kanë mesatare më të lartë në lëndën Informatikë në tre vitet e studimit në shkollën e mesme.

Për programin e studimit “Bachelor në Biologji”:

1. Renditja e maturantëve kandidatë të bëhet sipas mesatares së përgjithshme nga MASR.

2. Në rastet kur mesataret e kandidatëve janë të barabarta të bëhet listimi rendor i tyre duke u bazuar në mesataren e lëndëve Biologjike gjatë viteve të studimit në shkollën e mesme.

Për programin e studimit “Bachelor në Kimi”:

1. Renditja e maturantëve kandidatë të bëhet në bazë të mesatares së shkollës së mesme.

2. Ndër kandidatët me pikë të barabarta përparësi kanë kandidatët që kanë mesatare më të lartë në lëndën Kimi në tre vitet e studimit në shkollën e mesme.

d) Fakulteti i Ekonomisë:

Për programet e studimit: “Bachelor në Administrim Biznesi”, “Bachelor në Menaxhim në Turizëm”, “Bachelor në Marketing” kriteret e pranimit të studentëve në këtë cikël të parë të studimit të jenë:

1. Kriteret e parashikuara sipas Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 74 pika 1, “Pranimi në ciklin e parë të studimeve”, ku cilësohet:

“Pranimi në programet e ciklit të parë të studimit është i mundur për cdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK

2. Nota Mesatare e përgjithshme në tre vitet e studimit duke përfshirë dhe provimet e Maturës Shtetërore.

Për programin e studimit “Bachelor në Ekonomiks”:

1. Kriteret e parashikuara sipas Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 74 pika 1, “Pranimi në ciklin e parë të studimeve”, ku cilësohet:

“Pranimi në programet e ciklit të parë të studimit është i mundur për cdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar cdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave”.

2. Nota Mesatare e përgjithshme, duke përfshirë edhe provimet e maturës, të përbëjë kriterin e vetëm në vlerësimin dhe rankimin e kandidatëve. Pranimi i studentëve të rinj në vitin akademik 2018-2019 të kryhet 100% në bazë të mesatares së tre viteve të studimeve në ciklin e mesëm përfshirë në llogaritje edhe mesataren e provimit të maturës shtetërore.

Për programet e studimit: “Bachelor në Financë”, “Bachelor në Kontabilitetit”: 1.

Kriteret e parashikuara sipas Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 74 pika 1, “Pranimi në ciklin e parë të studimeve”, ku cilësohet:

“Pranimi në programet e ciklit të parë të studimit është i mundur për cdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar cdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave”.

2. Nota Mesatare e përgjithshme në tre vitet e studimit duke përfshirë dhe provimet e Maturës Shtetërore.

3. Vendimi protokollohet dhe i percillet MASR-it.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. Roland Zisi

